



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më 14.09.2020 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSBB, Nënkyretarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtoret e Drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezentë këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpala e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2020 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Ky është takimi i pestë për vitin 2019 i KKSBB-së. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;
 - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjishëm
 - Mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë,
 - Vetëdijesimi nga minat dhe mjetet tjera të pa shpërthyera nga lufta,
 - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta,
 - Siguria në trafik.
 - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit.
4. Informatë rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2020 -2021;
5. Të ndryshme.

Krvetari - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e vë në votim. Konsistoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë rreth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit.

Smajl Latifi– Të nderuar, sa i përket menaxhimit të situatës me Covid – 19, ne si komunë i kemi të gjitha të dhënat që nga fillimi i kësaj pandemie, por nuk do ju ngarkoj me ato sepse edhe në mbledhjen e kaluar ju kam dhënë një informatë të tillë. Po ashtu i keni edhe në web faqen e komunës së Rahovecit, në pikë të shkurtëra do ju jap edhe për këta dy muaj një informatë sa i përket Covid – 19. Deri më tanë në komunën e Rahovecit kemi 126 të shëruar nga virusi Covid – 19, raste aktive deri më tanë kemi 44, kurse të vdekur nga virusi Covid në komunën e Rahovecit janë gjithsej 47. Po ashtu edhe

një rast është konfirmuar me fatalitet dje, sipas informatave që na kanë ardhur, ai ka vdekur në Stamboll të Turqisë, edhe ky person ka qenë i konfirmuar me Covid – 19. Ne kemi bërë një testim në bazë të interesimit të vetë mësimdhënësve para fillimit të vitit shkollor, fatbardhësish kemi një numër të vogël të mësimdhënësve të infektuar me Covid – 19, testimi do të vazhdojë sipas rasteve dhe kërkësave të nevojshme. Ne si komunë jemi duke u përpjekur që në fillim të muajit tetor të fillojmë edhe me testimin me testet serologjike. Vazhdojmë të bëjmë dezinfektimin e objekteve të institucioneve të komuniës, po ashtu tani kemi bërë edhe dezinfektimin e shkollave, çerdheve dhe hapësirat e rëndësishme publike. Ne si komunë kemi material të bollshëm si masë parandaluese të përhapjes së virusit Corona – 1, përfaktin që sot edhe ashtu ka filluar mësimi në shkollat tona. Kemi një relacion të mirë të bashkëpunimit edhe me IKSHP-në, po ashtu edhe me qendrat të mjekësisë rajonale të Institutit Kombëtar si të Gjakovës ashtu edhe të Prizrenit. Prandaj ne duhet të mësohemi që virusi ekziston dhe ne jemi duke jetuar me të, prandaj ne të gjitha aktivitetet tona jemi duke u përpjekur që ti bëjmë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e institucioneve kompetente. Ne në QKMF mundemi të themi që kemi një personel të mjaftueshëm shëndetësor për tu përballur edhe me tutje me gjendjen që e kemi si pasojë e kësaj pandemie. Ne si komunë kemi një mbështetje nga Ministria e Arsimit me një shumë prej 193,000.00 €, këto mjete janë ndarë përmbrrojtjen nga Covid-19, po ashtu edhe nga Ministria e Shëndetësisë do të kemi një fond që do t'i dedikohet veprimeve dhe detyrvave të punonjësve tanë shëndetësorë përluftim të virusit Covid – 19. Gjithashu e di që ju keni edhe informata të ndryshme, mundeni të keni informata që dikush nuk është duke i respektuar masat e institucioneve kundra Covid – 19, por besoj se policia e Kosovës dhe inspektorati i komunës janë duke vepruar në drejtim të térheqjes së vëmendjes dhe vërejtjes për ata që nuk i respektojnë masat kundër Covid – 19. Ne si komunë kemi humbje evidente nga situata e pandemisë, ne e kemi një raport sa i përket humbjeve të komunës sonë nga Covid – 19, ky raport është bërë nga një kompani e cila është e profesioniste përkëtë gjëra, komuna jonë deri me datë 30 qershor të këtij viti ka pasuar humbje pëtreth 36 milion € në të gjithë sektorët, nëse vazhdojmë me këto kufizime ende, parallogaritjet që janë bërë nga kjo kompani është se do të kemi rrëth 54 milion € humbje. Por shpresoj se me kalimin e ligjit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pra pakoja përimëkëmbje ku ne si komunë do të përpinqemi që në maksimalisht të përfitojmë dhe ato biznese të cilat kanë humbur t'i dalim në ndihmë. Si pasojë e virusit kanë vështirësi edhe bujqit sepse nuk kanë ku t'i plasojnë produktet e tyre, pastaj sektori i qumështit është shumë keq, ekziston mundësia e kolapsit të stallave të të gjitha begative, përsyё se qumështin që e grumbullojnë fermerët nuk kanë ku ta dorëzojnë. Por ne jemi duke shpresuar se në ndihmën e qeverisë qendrore ku sadopak do të ndikojë në përmirësimin e barrës të madhe që e kanë qytetarët e komunës së Rahovecit si pasojë e virusit Covid – 19. Fjala është e juaja.

Shani Hoti – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, posaçërisht për ju që jeni duke e bërë gjithë këtë punë në tërë këtë situatë që gjendemi, desha një informatë ta di përpos qytetarëve civilë që duhet të paraqiten nëse janë me simptoma të Covid – 19 ose janë të infektuar, mendoj se përfaqësuesit e bizneseve duhet medoemos të paraqiten dhe të tregojnë që janë me Covid – 19 sepse ata përbjijnë më shumë rrezik në përhapje të tjerët. Kam një informacion i cili nuk është zyrtar por në një vendbanim të komunës sonë një person i ka 2-3 biznese dhe dyshohet që është i infektuar me Covid – 19 por biznesi i tij është duke funksionuar dhe ai punon aty, unë këtë e shohë si rrezik për banorët e atij vendbanimi, prandaj desha ta di si qëndron puna në këso raste.

Smajl Latifi - Është shumë e saktë ajo që thatë i nderuar, e di edhe për cilin rast jeni duke thënë dhe për cilin vendbanim, kur rezultatet vinë pozitive nga IKSHP-ja, menjëherë vepron drejtoria e shëndetësisë dhe policia, në këtë rast duhet të përfshihet edhe inspektorati i komunës, prandaj personit në fjalë përpos që duhet të i tërhiqet vërejtja duhet edhe të dënohet. E them këtë sepse duhet të kihet shumë kujdes sepse dikush e kalon lehtë këtë virus por dikush pëson edhe tragjikisht me vdekje, prandaj i ftojë organet tonë që të veprojnë energjikisht pa asnje hezitim. Duhet të dini një fakt nëse e llogarisim numrin e banorëve në komunën tonë dhe vdekjet nga Covid – 19, na del që kemi një numër goxha të madh, mundemi të dalim edhe të parët në Republikën e Kosovës për rastet me vdekje, prandaj

nuk duhet të neglizhojmë asnjë rast, i lus organet komunale dhe Policinë e Kosovës të intervenojnë në çdo rast që duhet. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.

Smajl Latifi - Në pikën e tretë të rendit të ditës të mbledhjes së KKSB-së, potencoja se gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën tonë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, gjithmonë flas duke u bazuar në bazë të informatave të cilat më vijnë nga stacioni policor në Rahovec. Nuk kemi ndonjë rast për tiu informuar me diçka e çka do ja viente dhe do hynte në atë që ne e quajmë prishje të gjendjes së sigurisë në komunën tonë, për më shumë fjalën ja kaloj komandantit të stacionit në Rahovec z. Fazli Morina.

Fazli Morina - Sa i përket sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit konstatoj se ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu edhe në këto ditë të muajve raportues korrik- deri me 10 shtator, menaxhimi i situatës së krijuar nga Covid – 19, në zonën tonë të përgjegjësisë, të gjitha njësitë e stacionit të policisë në Rahovec kanë qenë të angazhuar në drejtësim të implementimit të planit operativ për gatishmëri dhe reagim për Covid – 19. Në kuadër të këtij plani patrullat janë asistuar edhe nga njësitë tjera siç është njësia speciale operative nga qendra, pastaj njësia për reagim të shpejtë në Gjakovë, po ashtu edhe nga njësitë i komunikacionit rrugor të Gjakovës. Po ashtu kemi pasur bashkëpunim të mirë me inspektoratin qoftë nga qendra qoftë inspektoratit komunal, ku kemi bashkëvepruar në bazë të kërkesave dhe nevojave në teren rrëth menaxhimit të situatës së pandemisë. Gjatë kësaj periudhe janë të regjistruara 4 raste të veprave penale për moszbatim të vendimeve të qeverisë, kurse për mosmbajtjen e maskave janë shqiptuar diku rrëth 300 gjoba, ne si polici jemi tepër të zhgënjer me zbatimin e masave nga qytetarët, pra jemi të pakënaqur, ky numër është i vogël në krahasim me atë që është dashur të gjobiten.

Gjatë periudhës raportuese korrik – 10 shtator janë regjistruar 88 raste në përgjithësi, nga këto 85 janë vepra penale dhe 3 incidente të ndryshme, 5 janë vjedhje të lehta, vjedhje të rëndë 6, mbajtja e paautorizuar e armëve kemi vetëm 1 rast, kurse dhuna në familje është në rritje ku kemi pasur 9 raste. Njësitë përkatës të stacionit policor në Rahovec kanë mare të gjitha veprimet e nevojshme, të gjitha këto raste janë duke u hetuar.

Kurse sa i përket situatës së sigurisë në trafik, ne si polici jemi në vazhdimësi duke ndërmarrë masa të nevojshme të sigurisë për ti mundësuar të gjithëve kategorive pjesëmarrësve në komunikacion një lëvizje të sigurt, posaçërisht kategorisë më të rrezikuar e këto janë fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevojat e veçanta etj. Po ashtu lirishtë mundemi të themi se qyteti është i pastruar nga parkimi vend e pa vend i makinave, mundet të ketë edhe në ndonjë vend por aksioni do të vazhdoj, ne nuk do të tolerojmë asnjë parking në trotuarë. Por ne si polici jemi të pakënaqur me eksposimin e mallrave të disa lokaleve në qytet, ne këtë problem në çdo takim e përsërisim si temë, por lirishtë mundemi të themi se nuk ka asnjë angazhim sepse asnjëri nga këto lokalet nuk e kanë hequr mallrat e ekspozuara, kjo situatë vazhdon ende e njëjtë.

Siguria në shkolla, policia vazhdimisht është duke u përkushtuar për sigurinë në shkolla, kurse gjatë periudhës raportuese plani operativ i policisë për sigurinë në shkolla nuk është implementuar për arse se të gjitha këto plane janë pezulluar nga drejtoria rajonale, por kjo nuk do të thotë se nuk do të vazhdojnë më, ne jemi duke pritur vendimin tjetër. Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është raportuar asnjë rast sa i përket objekteve shkollore, por ajo që ja vlen të ceket është se e datë 29.08. 2020 është implementuar plani operativ për mbajtjen e testit të maturës i cili është mbajtur në 5 qendra dhe në bazë të raportove çdo gjë ka shkuar sipas planit dhe pa asnjë incident. Kjo ishte në pikë të shkurta.

Lulzim Krasniqi - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem me nën pikën Identifikimi i hapësirave publike për qasje sa më të lehtë të personave me nevoja të veçanta, e kam një propozim që në bashkëveprim me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe policinë e trafikut, të dalim së bashku në teren dhe ta bëjmë identifikimin e të gjitha hapësirave dhe objekteve që nuk kanë qasje për

persona me nevoja të veçanta. Në fund të bëhet një plan i përbashkët ku do ti mundësohet një qasje sa më e mirë.

Shaip Shala – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, edhe pse nuk e kemi në rend dite masat e parandalimit për lëmoshë- kërkuesit, në mbledhjet e kaluara kemi biseduar mjaftë këtë problematikë, desha një përgjigje nga komandanti se deri ku kanë arritur për parandalimin e kësaj dukurie. E ngrita këtë shqetësim sepse Rahoveci ka filluar të vërshohet nga lëmoshë kërkuesit, sipas disa informatave një person i sjellë me kombi deri në Rahovec ku i pastaj i lë te Podrumi i Vjetër Haxhijaha dhe më vonë i merr përsëri. Unë edhe vetë e kam pasur një rast të pakëndshëm sepse jam ballafaquar ose sulmuar verbalishtë me një vajzë me të meta psikike e cila është nga Rahoveci, prandaj se kjo dukuri e lëmoshë kërkuesve mundet të zgjidhet edhe me bashkëpunim të policisë me policinë kufitare, pra të bëhet identifikimi i tyre.

Fazli Morina – I nderuar, është e vërtetë ajo që e thatë, por lëmoshë kërkues nuk është që ka vetëm në Rahovec por ka në tërë Kosovën, pastaj jo vetëm në qytetet por ka edhe nëpër fshatra, por sa i përket asaj ne si polici i kemi numrin publik dhe ftoj të gjithëve që të na kontaktojnë dhe ne pastaj do të angazhohemi, por mendimi imë është se edhe pse ka lëmosh kërkues në komunë tonë por është një numër shumë i vogël nëse e krahasojmë me qytetet e tjera sepse vetë jam në udhëtim çdo ditë dhe jam duke parë se sa ka nëpër qytetet tjera. Në të kaluarën është e vërtetë që kanë qenë të organizuar ku i kanë sjellë nga Shqipëria në Kosovë, ko nuk ndodhë më sepse e dini siç është situata edhe në procedurë të rregullt është vështirë të kalohet kufiri, por nëse kanë qenë ata lëmosh kërkues nga Shqipëria, po ju informoj se 4 familje jetojnë në fshatin Xerxë që një kohë të gjatë, ku meshkujt e tyre mbledhin hekurina kurse fëmijët dhe gratë janë në kërkim lëmoshë, për këtë e kemi informuar edhe policinë rajonale në Gjakovë dhe me këtë rast do te merret njësiti i emigrimit. Kurse sa i përket të prekurve me Covid – 19, atyre askush nuk mundet tu pengojë që të shkojnë për kontroll tek mjeku, kjo nuk është e ndaluar me vendim, sepse informatat ndonjëherë po na vijnë të shtrembëruara, kurse ata që shkojnë nëpër markete ose janë duke u shëtitur nëpër rrugë dhe pastaj tek mjeku, ne kemi disa raste të iniciuara dhe janë në proces. Por ne kishim kërkuar përkrahje nga qytetarët sepse ne nuk mundemi të dimë gjithçka.

Smajl Latifi - Ju falënderoj për diskutimin e bërë rreth kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës:

4. Informatë rreth përgatitjeve për fillimin e viti të ri shkollor 2020 -2021;

Avni Morina – Drejtori i DKAS-ës – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, do të përpinqem në pikë të shkurtra të ju përgjigjem për ecurinë e fillimit të viti të ri shkollor. Me vendim të MASHT-it dhe në koordinim me MSH-së dhe të gjitha institucioneve relevante, ishte mare vendim që viti shkollor të shtyhet për 14 shtator 2020, tani ky vite shkollor ka filluar sot dhe kjo është bërë në përputhje të udhëzuesin e përgjithshëm të MASHT-it, në koordinim të plotë me MSH-së, IKSHP-së, me këshillin e prindërve dhe SBASHK-un. Secila komunë para se të fillojë viti shkollor ka themeluar task forcën komunale ku i princi Kryetari i Komunës dhe kjo task forcë është në koordinim të plotë me task forcat e shkollave. Fillimi është bërë përgatitja e duhur për fillimin e viti shkollor, janë furnizuar shkollat me tekste mësimore nga klasat 0-9, është bërë dezinfektimi i shkollave, janë pajisur të gjithë nxënësit e shkollave me maska, ku një donacion ka ardhur nga MASHT-i, po ashtu nga USAID dhe UNICEF, si pajisje higjenike dhe dezinfektues, ku pastaj këto janë shpërndarë nëpër shkolla. Pra për fillim të këtij viti të ri shkollor janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, po ashtu në mbledhjen e mbajtur nga task forca e cila është mbajtur 2 ditë para se t'i fillojë mësimi, ka dalë me një plan konkret: Sipas këtij plani shkollat e mëdha kanë filluar me mësime me nivelin e klasave 0,1,2,3,6, ,kurse shkollat që kanë numrin e nxënësve mesatar nga 200-500 nxënës, klasat që kanë filluar mësimin janë nga niveli 0-6, kurse shkollat që kanë pak nxënës kanë filluar të punojnë me të gjithë klasat pra nga klasa 0-9. Sot ne ishim në vizitë me kryetarin dhe nënkyetarin në disa shkolla, po ashtu kam marr informatë nga të gjithë drejtoret e shkollave se mësimi ka filluar në të gjitha shkollat ashtu siç është përcaktuar me planin e task forcës. Sipas udhëzimit të MASHT-it mësimdhënësit dhe nxënësit janë të obliguar të bartin maska dhe të bëhet dezinfektimi i duarve. Në fazën e dytë e cila planifikohet të jetë me 22 shtator 2020 të fillohet me klasë të tjera të cilat nuk kanë filluar me 14 shtator.

Smajl Latifi– Shfrytëzoj rastin tua uroj nxënësve, mësimdhënësve po ashtu edhe prindërve për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2020 2021, duke qenë të bindur se i kemi kuptuar qartë rekomandimet kundra Covid – 19. Ne si komunë jemi duke bërë përpjekje që ti rregullojmë nyjet sanitare në mënyrë që nxënësit të kenë kushte sa më të mira. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

5. Të ndryshme .

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket pikës së fundit, nëse jo atëherë ju falënderoj për diskutimin e zhvilluar në këtë mbledhje, shihemi në takimet e radhës.

Procesmbajtësi

Agim Hoti

Kryetar i Komunës

Smajl Latifi

